



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 105 dt.13.01.1994

**PER
KALIMIN E NJE PJESE TE AKTIVITETIT NGA NDERMARRJA
TREGTARE E BUKES NE FABRIKEN E BUKES**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.13.01.1994, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Tregtisë dhe Industrisë Ushqimore, në mbështetje të ligjit “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, neni.30,

V E N D O S I

1. Të kalojnë 25 njësi buke nga Nd.Tregtare e Bukës në Fabrikën e Bukës.
2. Të dy ndërmarrjet të lidhin akt – marrëveshjen për kalimin e 25 njësive, të personelit shitës dhe administrativ si dhe të mjeteve të transportit.
3. Nd.Tregtare e Bukës të organizojë punën që në njësitë e veta të tregtojë dhe artikuj ushqimorë.
4. Njësitë e mësipërme të mos privatizohen nga Fabrika e Bukës por vetëm të kalojnë në vartësi administratorëve të saj.
Me daljen e ligjit për pronat e Bashkisë, si këto njësi ashtu edhe ato që ngelen në varësi të Nd.Tregtare të Bukës të kalojnë në pronësi të Bashkisë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Seksioni i Tregtisë që në bashkëpunim me dy ndërmarrjet e mësipërme të ngrejë komisionin për kalimin e njësive.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA